



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMITETI I INVESTIMEVE STRATEGJIKE**

**VENDIM**

**NR. 1, DATË 07 / 05 / 2024**

**PËR MOSPRANIM TË KËRKESËS PËR PËRFITIM TË STATUSIT  
“INVESTIM/INVESTITOR STRATEGJIK PROCEDURË E VEÇANTË” PËR  
PROJEKTIN E INVESTIMIT “PLAYA Y MAS- HOTEL DHE RESIDENCA,  
GOLEM” ME SUBJEKT APLIKUES LUANI SHPK NUIS J66703045Q**

Në mbështetje të Nenit 9, nenit 13, nenit 17 pika 5 të Ligjit Nr. 55/2015, “Për Investimet Strategjike në Republikën e Shqipërisë”, Kreu I, pika 3/c të VKM Nr. 1023, datë 16.12.2015 “Për Nënsektorët Strategjikë dhe Zonat me Përparësi Zhvillimi” dhe Kreut II, pika 8, 10 e VKM Nr. 1026, datë 16.12.2015 “Për vlerësimin e dokumentacionit të investimeve strategjike”, Komiteti i Investimeve Strategjike vlerësoi se:

- Projekti i investimit parashikon ndërtimin e resorti turistik, ku do të ketë një fshat turistik dhe një hotel me 5 Yje me ambiente shërbimi në një sipërfaqe prej afërsisht 168,195 (njëqind e gjashtë dhjetë e tetë mijë e njëqind e nëntëdhjetë e pesë) m<sup>2</sup> në fshatin Golem, Bashkia Kavajë.
- Vlera e investimit për projektin e propozuar parashikohet të jetë 110,673,253 Euro (njëqind e dhjetë milion e gjashtëqind e shtatëdhjetë e tre mijë e dyqind e pesëdhjetë e tre) Euro dhe numri i të punësuarve parashikohet të jenë gjatë ndërtimit 325 punonjës dhe gjatë operimit 425 punonjës.
- Pasuritë e paluajtshme që preken nga projekti i investimit të propozuar në ZK Nr. 2099 janë një pjesë pronë private, lloji pasurisë ”arë”, përkatësisht pasuritë me numër 13/13, 13/15, 13/16, 13/17, dhe pjesa tjetër pronë “shtet”, përkatësisht pasuritë me numër 13/20 dhe nr. 13/28, lloji pasurisë “ranishte”.

Në përfundim, pasi u njoh me gjithë dokumentacionin e nevojshëm,

## **KOMITETI I INVESTIMEVE STRATEGJIKE**

### **VENDOSI:**

1. Mospranimin e kërkesës për përfshirjen e projektit investues “Playa Y Mas- Hotel dhe Residencia, Golem”, me subjekt investues Luani shpk NUIS J66703045Q, Bashkia Kavajë në procedurën e veçantë dhe mbështetjen që ofron ky status.
2. Projekti i propozuar bie ndesh me parashikimet e Ligjit Nr. 9244, datë 17.06.2004, “Për Mbrojtjen e Tokës Bujqësore”, i ndryshuar, pasi në llojin e pasurive “arë” në të cilën synohet të zhvillohet projekti i investimit nuk lejohet ndërmarrja e veprimtarisë së kërkuar nga subjekti.
3. Sipërfaqet e zërit kadastral “ranishte” nuk përfshihen tek destinacionet e parashikuara në VKM Nr. 1030/2015, të cilat kalohen në Fondin e Pasurive të Paluatjshme për Mbështetjen e Investimeve Strategjike (FPPMIS), por as edhe nuk mund t’i nënshtrohen procedurave që i perkasin VKM Nr. 807/2019.
4. Bregu i detit nuk është pjesë e hartës së zonave për stacione plazhi për shkak të erozionit detar, për të cilin do duhet të merren masa ndërhyrjeje për eliminimin e tij dhe kthimin e brezit ranor.
5. Vendimi i Komitetit të Investimeve Strategjike publikohet dhe regjistrohet në Regjistrin e Investimeve Strategjike dhe i njoftohet kërkuarit nga Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve, në rolin e saj të Sekretariatit të Komitetit të Investimeve Strategjike.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

## **KRYETAR I KOMITETIT TË INVESTIMEVE STRATEGJIKE**

### **KRYEMINISTËR**

EDI RAMA

**ZËVENDËSKRYEMINISTËR**

**MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË**

BELINDA BALLUKU

**MINISTËR I EKONOMISË KULTURËS DHE INOVACIONIT**

BLENDI GONXHJA

**MINISTËR I FINANCAVE**

ERVIN METE

**MINISTËR I TURIZMIT DHE MJEDISIT**

MIRELA KUMBARO

**MINISTËR I BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL**

ANILA DENAJ

**AVOKATI I PËRGJITHSHËM I SHTETIT**

ODISE MOÇKA

**SEKRETARIATI TEKNIK I KIS  
LAURA PLAKU (SARO)**